

DDB Albania Sh.a

**Pasqyrat financiare te konsoliduara
per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017
(se bashku me raportin e audituesit te pavarur)**

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	I,III
Pasqyra e konsoliduar e performances	1
Pasqyra e konsoliduare pozicionit financiar	2
Pasqyra e konsoliduar e flukseve monetare	3
Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve ne kapital	4
1 Informacion i përgjithshem	5
2 Ndryshimet ne politika kontabël	5
3 Politika kontabel te rendesishme	6
4 Menaxhimi i rrezikut financiar	14
5 Gjykime dhe vlerësime tërëndësishmekontabël	18
6. Te ardhurat	19
7. Kosto te sherbimeve te siguruara	19
8. Shpenzime personeli	19
9. Shpenzime administrative	20
10. Te ardhura financiare	20
11. Shpenzime financiare	20
12. Shpenzime te tatimit mbi fitimin	20
13. Aktive jo-materiale	21
14. Aktive materiale	22
15. Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme	23
16. Te arketueshme nga palet e lidhura	23
17. Tatim fitimi i parapaguar	23
18. Mjete monetare dhe ekuivalente me to	23
19. Aktive te tjera	23
20. Detyrime ndaj institucioneve financiare	24
21. Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme	24
22. Detyrime ndaj paleve te lidhura	24
23. Palet e lidhura	25
24. Ngjarjet pas datës se raportimit	25

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Opinionin me Rezerve

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë DDB Albania Sha. (me poshtë referuar si “Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital, pasqyrën e konsoliduar të flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, duke përfshirë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, përveç efektit të çështjes së përshkruar në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale gjëndjen financiare të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2017, rezultatin financiar dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

Baza për Opinionin me Rezerve

Në pasqyrat financiare të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2017 llogari të arketueshme tregtare dhe llogari të tjera të arketueshme pasqyrohen në shumën 68.502.045 Lekë. Nga këto 5.194.998 Lekë janë kliente të paarkëtuar për më shumë se 2 vite, e për të cilat Shoqëria nuk ka parashikuar zhvlerësim. Ne nuk kemi marrë konfirmim direkt nga klientët për këtë shumë, ose të merrnim siguri me procedura të tjera auditimi për këto kërkesa për arkëtim në datën 31 dhjetor 2017. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të sigurohemi në lidhje me mundësinë e arkëtimit të këtyre shumave. Në opinionin tonë Shoqëria duhet të krijojë një fond për zhvlerësimin e këtyre shumave.

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNAs). Përgjegjësia jone sipas këtyre standardeve përshkruhet në vijim në seksionin e raportit tonë “Përgjegjësia e audituesve për auditimin e Pasqyrave Financiare”. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe i kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Drejtimit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo pasaktësia.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar në kushtet e vijimësisë së biznesit, zbulimin, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me vijimësinë dhe përdorimin e bazës së vijimësisë të kontabilitetit, përveç rasteve kur drejtimi synon të likuidojë Shoqërinë ose të pushojë veprimtarinë, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër realiste përveç kësaj.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë dhënia e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo pasaktësia, dhe dhënia e raportit të audituesve që përfshin opinionin tonë. Siguri e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci që një kontroll i kryer në përputhje me SNA gjithmonë do të zbulojë një anomali materiale, kur ajo ekziston. Anomalitë mund të lindin nga mashtrimi apo pasaktësia dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato pritet që të ndikojnë vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive, planifikojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit, që u përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi, që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për bazat e opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një keq deklarimi material, që vjen nga mashtrimi është më i lartë se ai që vjen nga gabimet, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, mos përfshirje të qëllimshme, keq paraqitje, apo tejkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit, që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shënimeve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi të parimit të vijimësisë në kontabilitet dhe, duke u bazuar në evidencën e marrë gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose rrethanat që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar në kushtet e vijimësisë së biznesit. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit për paraqitjen e këtij informacioni në shënime shpjeguese të pasqyrave financiare ose, nëse këto shënime janë të papërshtatshme, për të modifikuar opinionin tonë.
- Në rastet e një misioni për auditimin e një grupi, marrim evidenca auditimi, që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënat financiare të njësisë ekonomike ose aktiviteteve tregtare brenda grupit për të shprehur një opinion për pasqyrat financiare të grupit. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe cilësinë e auditimit të grupit. Ne jemi të vetmit përgjegjës për opinionin e auditimit.

Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana në të ardhmen mund të detyrojnë njësinë ekonomike të mos vazhdojë më në kushtet e vijimësisë së biznesit.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje në lidhje me, midis çështjeve të tjera, qëllimin e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Midis çështjeve që ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë, nëse ka, ato çështje që kanë qenë më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiarë të periudhës aktuale dhe rrjedhimisht janë çështje kryesore auditimi. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç rasteve kur ligjet apo rregulloret e ndalojnë paraqitjen publike të çështjes ose kur, në raste shumë të rralla, ne vendosim që një çështje nuk duhet komunikuar në raportin tonë të auditimit sepse ndikimi negativ që do kishte, do të tejkalonte mjaftueshëm përfitimet e interesit publik të këtij komunikimi.

Baker Tilly Albania shpk.

Orjana Kalaja
Auditues Ligjor

Tiranë, 18 Dhjetor 2018



DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017

(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

Pasqyra e konsoliduar e performances

	Shenime	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2017	Viti imbyllur me 31 Dhjetor 2016
Te ardhura te shfrytezimit	6	144.828.259	274.285.935
Kosto e shitjeve	7	(102.446.061)	(205.330.578)
Fitimi bruto		42.382.198	68.955.357
Shpenzime personeli	8	(35.451.064)	(39.385.315)
Shpenzime administrative	9	(20.912.366)	(25.116.981)
Shpenzime te amortizimit	13/14	(3.856.221)	(3.917.655)
Provizjione		(2.604.999)	-
Te ardhura financiare	10	388.658	191.530
Shpenzime financiare	11	(1.123.086)	(839.932)
Humbja para tatimit		(21.176.880)	(112.996)
Tatimi mbi fitimin	12	-	(160.986)
Humbja e vitit		(21.176.880)	(273.982)
(Humbja)/Fitimi/ per:			
Zoteruesit e njesise ekonomike meme		(19.747.128)	(409.523)
Interesat e pakices		(1.429.752)	135.532
		(21.176.880)	(273.991)
Te ardhura te tjera gjithepershires			
Totali i te humbjes gjithepershires per vitin		(21.176.880)	(273.991)
Totali i te ardhurave/(humbjes) gjithepershires per:			
Zoteruesit e njesise ekonomike meme		(19.747.128)	(409.523)
Interesat e pakices		(1.429.752)	135.532
		(21.176.880)	(273.991)

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjithepershires duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguesenefaqet 5 deri 25 qe jane pjese perberese e pasqrave financiare.

DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017

(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

Pasqyra e konsoliduare pozicionit financiar

	Shenime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Aktive			
Aktive afatgjata			
Aktive jo-materiale	13	339.802	1.085.261
Aktive materiale	14	14.491.812	16.836.941
Totali i aktiveve afatgjata		14.831.614	17.922.202
Aktive afatshkurtra			
Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme	15	68.502.045	151.488.134
Te arketueshme nga palet e lidhura	16	10.418.166	8.871.423
Inventari		234.071	314.650
Tatim Fitimi i parapaguar	17	149.210	413.691
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	18	10.250.875	6.092.422
Aktive te tjera	19	54.356	4.582.291
Huadhenie		1.853.498	1.853.498
Totali i aktiveve afatshkurtra		91.462.221	173.616.109
Totali i aktiveve		106.293.835	191.538.311
Detyrime			
Detyrime afatgjata			
Detyrime ndaj institucioneve financiare	20	4.385.004	102.369
Totali i detyrimeve afatgjata		4.385.004	102.369
Detyrime afatshkurtra			
Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme	21	85.990.044	147.752.010
Detyrime ndaj paleve te lidhura	22	12.694.884	15.198.538
Detyrime ndaj institucioneve financiare	20	3.885.577	7.841.434
Totali i detyrimeve afatshkurtra		102.570.505	170.791.982
Totali i detyrimeve		106.955.509	170.894.351
Kapitalet e veta			
Kapitali i nenshkruar		3.500.000	3.500.000
Rezerva ligjore		578.325	564.566
(Humbje)/Fitime te pashpermdara		(4.577.706)	15.183.181
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike		(499.381)	19.247.747
Interesa jo-kontrolluese		(162.293)	1.396.213
Totali i kapitalit		(661.674)	20.643.960
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		106.293.835	191.538.311

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 25 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

DDB Albania Sh.a.


Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017


(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

Pasqyra e konsoliduar e flukseve monetare

Shenime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Flukset e parase nga aktiviteti i shfrytezimit		
Fitimi i vitit	(21.176.880)	(273.991)
<i>Rregullime per te ardhura e shpenzime jomonetare</i>		
Amortizimi	13,14 3.856.221	3.917.655
Dalje jashte perdorimi e aktive te paprekshme	(667.382)	-
Provizjione	1.000.000	-
Zhvleresim llogarive te arketueshme	1.604.999	-
Shpenzimi i tatim fitimit	-	160.986
<i>Fitimi operacional para ndryshimeve ne kapitalin punues</i>		
(Rritje)/ ulje ne tregtine e te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	15 81.381.082	(69.239.400)
Rritje/ (ulje) ne tregtine e te pagueshmeve dhe te tjera te pagueshme	21 (61.761.959)	79.931.876
(Rritje) / ulje ne inventar	80.581	(97.980)
Rritje/ (ulje) ne detyrimet per palet e lidhura	16 (1.546.744)	36.440.771
Rritje ne parapagimet per media	-	-
Rritje ne te ardhurat e shtyra	-	-
Rritje/ (ulje) ne detyrimet per palet e lidhura	22 (2.503.654)	(70.780.612)
(Rritje)/ ulje ne aktive te tjera	19 4.527.938	(4.492.958)
Tatim fitimi i paguar	264.481	1.022.531
Paraja neto nga aktivite shfrytezimit	5.058.683	(23.411.112)
Flukset e parase nga aktivite investuese		
Arketime nga shitja e aktiveve te paprekshme	333.853	-
Blerja e impianteve, pajisjeve dhe aktiveve jomaterialeve	(1.432.107)	(2.718.483)
Paraja neto e perdorur ne aktivite investuese	(1.098.254)	(2.718.483)
Flukset e parase nga aktivite financimi		
Ripagime/te ardhura nga huare	326.778	(36.883)
Dividende te paguar	(128.754)	(107.341)
Paraja neto (perdorur per)/nga aktivite financuese	198.024	(144.224)
Rritje/ Ulje ne mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre neto	4.158.453	(26.273.819)
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre ne fillim te vitit	6.092.422	32.366.241
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre ne fund te vitit	10.250.875	6.092.422

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve ne kapital duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 25 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare. Këto pasqyra financiare janë aprovuar më 29 Mars 2018 dhe janë firmosur në emër të tij nga:


Juela Isaj
Administrator


Klodiana Bllaci
Shefe finance



DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017
(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve ne kapital

	Kapitali themeltar	Rezerva ligjore	Fitime te mbartura	Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike	Interesa jo kontrollues	Totali i kapitalit
Gjendja me 1 janar 2016	3.500.000	553.096	15.604.174	19.657.270	1.368.022	21.025.292
Fitimi/(humbja)e vitit aktual			(409.523)	(409.523)	135.532	(273.991)
Te ardhura totale gjithepershires per periudhen			(409.523)	(409.523)	135.532	(273.991)
Transaksione me pronaret te njohura direkt ne kapital						
Rritje ne rezerva te tjera	-	11.470	(11.470)	-	-	-
Dividende te paguar	-	-	-	-	(107.341)	(107.341)
Totali i transaksioneve me pronaret	-	11.470	(11.470)	-	(107.341)	(107.341)
Gjendja me 31 Dhjetor 2016	3.500.000	564.566	15.183.181	19.247.747	1.396.213	20.643.960
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	-	-	(19.747.128)	(19.747.128)	(1.429.752)	(21.176.880)
Te ardhura totale gjithepershires per vitin	-	-	(19.747.128)	(19.747.128)	(1.429.752)	(21.176.880)
Transaksione me pronaret te njohura direkt ne kapital						
Rritje ne rezerva te tjera	-	13.759	(13.759)	-	-	-
Dividende te paguar	-	-	-	-	(128.754)	(128.754)
Totali i transaksioneve me pronaret	-	13.759	(13.759)	-	(128.754)	(128.754)
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	3.500.000	578.325	(4.577.706)	(499.381)	(162.293)	(661.674)

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve ne kapital duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 25 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017
(Shumat ne Leke, nese nuk specifkohet ndryshe)

1 Informacion i përgjithshem

DDB Albania Sh.A. (“Shoqëria”) ofron sherbime publicitare si per klientet brenda vendit ashtu edhe per te kufinjve. Burimet kryesore te te ardhurave te kompanise jane si ne vijim:

- Sherbime mediatike per kompanite ne baze komisioni;
- Prodhimi I spoteve publicitare per klientet – te ardhurat jane vendosur si perqindje te koston totale te prodhimit.
- Sherbime te tjera (fushata publicitare, media plane, aktivite ne fushen e reklamave), kundrejt nje cmimi fikse mbi te cilin eshte rene dakord.
- Sherbime te ofruara kundrejt pagesave mujore fikse.

Kompania eshte filial i Olympic DDB Holdings Cyprus Limited, e cila zoteron 60% te aksioneve, dhe indirekt, te Omnicom Group Inc. Pjesa tjetere e aksioneve zoterohet nga Ardian Garo (21%), Pandeli Garo (14%) dhe Admir Banaj (5%).

Me rezolute te Bordit Mbikqyres me date 26 Janar 2011, duke filluar nga data 1 Shkurt 2011 Znj. Juela Isaj u emerua administrator e kompanise duke zevendesuar Z. Ardian Garo.

Zyra e regjistruar e kompanise ndodhet ne Tirane, Rruga e Dibres, Observator Business Center, Kati 12, dhe me date 31 Dhjetor 2017 kishte te punesuar 14 punonjes (31 Dhjetor 2016: 14 punonjes).

Me 3 Dhjetor 2007, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve te DDB Albania Sh.a aprovoi krijimin e “Optimum Media” Sh.a, e cila ofron sherbime publicitare dhe aktivite te nderlidhura. Kjo kompani eshte regjistruar ne Regjistrin Tregtar me date 28 Shkurt 2008.

Fillimisht DDB Albania Sh.a ishte pronari i vetem i ketij filiali. Kapitali aksionar i Optimum Media Sh.a eshte 3,5 milion Lek ndare ne 3.500 aksione 1.000 Lek secili. Gjate vitit 2012, 660 aksione i jane transferuar me vlere nominale Znj. Vilma Maze dhe me 31 Dhjetor 2017, DDB Albania Sha pati nje pjesemarrje prej 67% (2016: 67%) dhe Znj. Vilma Maze 33% (2016: 33%).

Pasqyra financiare e konsoliduar perfshin Kompanine dhe filialin (bashke referuar si “Grupi”).

2 Ndryshimet ne politika kontabël

Standardet e reja dhe ato te ndryshuara efektive per periudhat vjetore duke filluar me ose pas datës 1 janar 2017

SNRF 16 Qiratë

IFRS 16 paraqet nje model te vetem kontabilizimi ne bilanc per qiramarrësit. Nje qiramarrës njih nje te drejte per te perdorur aktivin qe perfaqeson te drejten e perdorimit te ketij aktiviteti dhe njekohesisht perben edhe nje detyrim qiraje qe lidhet me obligimin per te shlyer pagesat e qirasë financiare. Ka disa perjashtime opsionale per qiratë afatshkurtra dhe qiratë per mjete me vlere te vogel. Kontabilizimi per qiradhënësin mbetet shume i ngjashem me standardin aktual – per shembull, qiradhënësi do te vazhdoje ta klasifikojë qiranë si financiare ose operative. SNRF 16 zevendeson udhezuesit aktualë te qirasë duke perfshtirë SKK 17 Qiratë, KIRFN 4 Percaktimi ne rast se nje marrëveshje permban nje qira, KIC-15 Qiratë operative – Incentivat dhe KIC-27 Vlerësimi i substancës së transaksioneve qe perfshtijnë formën ligjore te qirasë. Standardi është efektive per periudha vjetore qe fillojnë me dhe pas 1 janar 2019. Zbatimi i mëparshëm është i lejueshëm per ato entitete te cilat aplikojnë SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët ne datën ose perpara datës së zbatimit të SNRF 16. Shoqëria nuk pret qe standardi i ri te ketë nje ndikim te rëndësishëm ne pasqyrat financiare kur aplikohet fillimisht, per arsye se kontratat aktuale te qirasë maturohen ne 30 qershor 2018. Ndikimi aktual lidhur me adoptimin e SNRF 16 ne pasqyrat financiare te Shoqërisë do te varet nga kontratat e qirasë tek te cilat Shoqëria do te jetë palë.

Standardet e reja ose te amenduara ne vijim nuk pritet te kenë nje ndikim te rëndësishëm ne pasqyrat financiare te Shoqërisë.

2 Ndryshimet ne politika kontabël (vazhdim)

Amendime të tjera

Standardet e reja apo të ndryshuara më poshtë nuk pritet të kenë efekt të rëndësishëm mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë:

- SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët
- Iniciativa për Dhënie e Informacioneve Shpjeguese (Ndryshime në SNK 7)
- Njohja e Aktiveve Tatimore të Shtyra për Humbjet e Parezalizuara (Ndryshime në SNK 12)
- Klasifikimi dhe Matja e Transaksioneve të Pagesave të Bazuara në Aksione (Ndryshime në SNRF 2)
- Shitja ose Shtesa e Aktiveve ndërmjet një Investitori dhe Investimit të tij në një Pjesëmarrje ose në një Sipërmarrje të Përbashkët (Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28)
- Zbatimi i SNRF 9, Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimit (Ndryshimet në SNRF 4)
- Transferimi i Aktiveve Afatgjatë Materiale të Investuar (Ndryshimet në SNK 40)
- KIRFN 22 Transaksionet në monedhë të huaj dhe paradhëniet
- Përmirësime vjetore të SNRF-ve, cikli 2014-2016 (Ndryshime në SNRF 12 Dhënia e informacionit shpjegues mbi interesat në njësitë e tjera ekonomike dhe ndryshime në SNK 28 Për investimet e saj në pjesëmarrje apo në sipërmarrje të përbashkëta).

3 Politika kontabel te rëndësishme

3.1 Baza e përgatitjes dhe përputhshmërisë

(a) Baza e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e publikuara nga Komisioni i Interpretimeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KINRF") të BSNK. Zbatimi i SNRF-ve është sipas Ligjit Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 742, datë 7.11.2007.

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë pasqyruar në "Lek" e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

(d) Përdorimi i gjykimit dhe i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi i shoqërisë të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që mund të ndikojnë në aplikimin e politikave si dhe vlerave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet kryesore janë rishikuar në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në çdo periudhë të ardhshme në të cilën mund të ketë ndikim.

3 Politika kontabel te rëndësishme (vazhdim)**3.2 Bazat e konsolidimit**

Filialet janë të gjitha subjektet (duke përfshirë njësitë ekonomike për qëllime të veçanta) mbi të cilat Grupi ka fuqi për të qeverisur politikat financiare dhe operative, që në përgjithësi u atribuohen aksionereve që zoterojnë më shumë se gjysmën e të drejtave të votës. Ekzistenca dhe efekti i të drejtave votuese potenciale që janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme janë konsideruar kur është bërë vlerësimi nëse Grupi kontrollon një njësi tjetër ekonomike. Filialet janë konsoliduar plotësisht që nga data në të cilën kontrolli i është transferuar Grupit. Metoda e kostos është përdorur për të kontabilizuar blerjen e filialeve nga Grupi. Kostoja e blerjes është matur në vlerën e drejtë të aktiveve të dhëna, instrumentave të kapitalit neto të emetuara dhe detyrimeve të pësuar ose konstatuara në datën e këmbimit, plus kostot direkte të blerjes. Aktivitetet e identifikueshme të blera dhe detyrimet e konstatuara në një kombinim biznesi njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga interesi i pakicës. Tejkalimi i koston së blerjes mbi vlerën e drejtë të pjesës së grupit të aktiveve neto të identifikueshme njihet si emri i mirë. Transaksionet midis shoqerive të grupit, balancat dhe fitimet e përealizuara për transaksione ndërmjet shoqerive të grupit janë eliminuar. Gjithashtu janë eliminuar humbjet e përealizuara. Politikat kontabel të filialeve janë ndryshuar kur ka qenë e nevojshme për t'u përputhur me politikat e miratuara nga Grupi.

3.2.1 Ndryshimet ne interesat e pronesisë se Grupit ne filialet ekzistuese

Ndryshimet ne interesat e pronesisë se Grupit ne filiale qe nuk rezultojne ne humbje te kontrollit te Grupit mbi filialet jane konsideruar si transaksione te kapitaleve. Vlerat e mbartura te interesave te Grupit dhe interesat jo kontrolluese jane rregulluar per te pasqyruar ndryshimet ne interesat e tyre relative mbi filialet.

Cdo ndryshim midis vleres me te cilen interesat jo kontrolluese jane rregulluar dhe vleres se drejte te shperblimit te paguar ose marre njihet direkt si rezerva te tjera ne kaptalet e veta dhe i atribuohet pronareve te Kompanise.

Ne rastet kur Grupi humbet kontrollin mbi filialet, nje fitim apo humbje njihet dhe perlllogaritet si diference midis (i) Vleres se drejte agregate te konsiderates se marre dhe vleres se drejte te cdo interesi te mbartur dhe (ii) Vleres se mbartur te meparshme te aktiveve duke përfshirë emrin e mirë dhe detyrimet e filialeve dhe cdo interesi jo kontrollues. Të gjitha vlerat paraprakisht të njohura në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në lidhje me filialin respektiv konsiderohen sikur Grupi ka rregulluar direkt aktivitetet e lidhura ose detyrimet e filialit (p.sh. riklasifikuar në fitim ose humbje apo transferuar në tjetër kategori të kapitaleve sic specifikohet/lejohe nga SNRF-te e aplikueshme. Vlera e drejte e cdo investimi te mbartur ne filialet e meparshme ne daten kur kontrolli humbet shihet si vlera e drejte ne njohjen fillestare per kontabilitetin vijues nen SNK 39, kur aplikohet, kostoja e njohjes fillestare te nje investimi eshte nje pjesemarrje ose shoqeri e perbashket.

3.2 Kombinimet e bizneseve dhe emri i mirë

Kombinimet e biznesit kane adoptuar metoden e blerjes. Kostoja e blerjes matet si shumatore e vleres se blerjes te llogaritur ne vleren e drejte ne daten e blerjes dhe vlera e cdo interesi jo kontrollues mbi blerjen. Per cdo kombinim biznesi, grupi percakton nese do te mate interesat jo kontrolluese mbi vlerën e drejte apo ne pjese proporcionale te aktiveve te identifikueshme neto te blerjes. Kostot e blerjes, kur llogariten, përfshihen në shpenzimet administrative. Kur Grupi blen një filial, ai vlerëson aktivitetet financiare dhe detyrimet e konstatuara për klasifikim të pershtatshëm dhe planifikim në përputhje me kushtet e kontrates, rrethanat ekonomike dhe kushtet perkatëse në datën e blerjes. Kjo përfshin ndarjen e derivativeve të përfshira në kontratën e blerjes.

Ne rast se kombinimet e biznesit arrihen hap pas hapi, cdo interes kapitali i mbajtur paraprakisht rilloqaritet ne vleren e drejte te dites se blerjes dhe cdo fitim apo humbje e ndodhur njihet si fitim ose humbje.

DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017
(Shumat ne Leke, nese nuk specifkohet ndryshe)

3. Politika kontabel te rëndësishme (vazhdim)

Cdo shperblim per t'u transferuar nga bleresi do te njihet me vleren e drejte ne daten e blerjes. Shperblimet e klasifikuara si aktive ose detyrime, pra instrumente financiare dhe ne kuader te SNK 39 "Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja", llogaritet ne vleren e drejte me ndryshimet ne vleren e drejte te njohura, si fitim ose humbje apo si modifikim ne pasqyrën e kapitaleve. Nese shperblimi nuk i perket kuadrit te SNK 39, ai matet ne perputhje me SNRF e duhur. Shperblimet qe klasifikohen si kapitale nuk rillogariten dhe rregullimet pasuese do te konsiderohen brenda pasqyrës se kapitaleve.

Emri i mire eshte fillimisht i matur ne kosto, duke qene teprica e shumatores te vleres se blerjes dhe vlera e njohur per interesat jo kontrolluese, dhe cdo interes i meparshem i mbartur, mbi aktivet e identifikueshme neto te blera dhe detyrimet e konstatuara. Nese vlera e drejte e aktiveve neto te blera eshte me teprice ne lidhje me vleren e totalit te blerjes, Grupi rivlereson nese i ka identifikuar sakte te gjitha aktivet e blera dhe te gjitha detyrimet e konstatuara dhe rishqyrton procedurat e perdorura per te llogaritur vlerat qe do te njihen ne daten e blerjes. Nese rivleresimi rezulton ende ne teprice te vleres se drejte te aktiveve neto te blera mbi vleren e totalit te blerjes atehere fitimi do te njihet si fitim ose humbje.

Pas njohjes fillestare, emri i mire do te matet ne kosto duke zbritur humbjet e zhvleresimeve te mbartura. Per qellim te testimave per zhvleresim emri i mire i blere ne nje kombimin biznesi duke nisur nga data e blerjes, eshte alokuar ne cdo njesi gjeneruese te parase te Grupit, qe pritet te perfitojne nga kombinimi, pa konsideruar nese aktive te tjera ose detyrime te blerjes i caktohen atyre njesive.

3.3 Parimi i vijimësisë

Te dhenat e kontabilitetit jane mbajtur duke qene ne perputhje me parimet e pergjithshme te kontabilitetit, ne menyre te vecante me bazen e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhës, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit ne vijimesi.

Pasqyrat financiare jane pergatitur sipas parimit te vijimesise. i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjate ecurise normale te biznesit.

3.4 Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Të gjitha humbjet dhe fitimet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e këtyre transaksioneve dhe nga rivlerësimi i zërave monetare ne monedhë të huaj me kursin e këmbimit të fundit të vitit njihen në fitim ose humbje.

Zërat jo-monetare nuk ri këmbehen në fund të periudhës dhe maten me kosto historike (këmbehen duke përdorur kursin e këmbimit në datë kur është kryer transaksioni). përveç rasteve kur zërat jo-monetare maten me vlerë të drejtë të cilat këmbehen duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të aplikuara (Lek kundrejt monedhave të tjera të huaja) për monedhat kryesore me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
USD	132,95	128,17
EUR	111,10	135,23

DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017
(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

3. Politika kontabel te rëndësishme (vazhdim)

3.5 Aktivete afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Elementet e aktiveve afatgjata materiale mbahen me kosto historike pakësuar zhvlerësimin e akumuluar (si më poshtë) dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë (referohuni politikën kontabel 3.5).

Kostot historike përfshijnë të gjitha shpenzimet që i atribuohen marrjes dhe përdorimit të aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë përfshin kostot e materialeve dhe punën direkte. dhe çdo kosto tjetër të atribuueshme për sjelljen e aktivitetit në kushte pune për përdorimin e destinuar të tij, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktivitetit si dhe rregullimin e vendit në të cilin janë vendosur dhe kapitalizimin e kostos së huamarrjeve.

Në rastet kur elementet e një aktiviteti material afatgjatë kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme. ato mbahen si aktive afatgjata materiale më vete (komponentët kryesore).

(ii) Kostot e mëpasshme

Kosto e zëvendësimit të pjesëve të aktiveve afatgjata materiale i shtohet vlerës së mbartur të aktivitetit vetëm në qoftë se parashikohet që kjo pjesë të sjellë përfitime ekonomike në të ardhmen për shoqërinë dhe kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve materiale afatgjata njihen në shpenzimet e periudhës kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi (Amortizimi)

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metoden lineare apo zbritese të amortizimit. mbi jeten e vlerësuar të çdo pjesë të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën me të shkurtër midis periudhës së qirës dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Instalime teknike	Mbi vlerën kontabel neto	5%
Mobilje dhe pajisje zyre	Mbi vlerën kontabel neto	20%
Automjete	Mbi vlerën kontabel neto	20%
Pajisje informatike	Mbi vlerën kontabel neto	25%

Vlera e mbetur dhe jetëgjatësia e aktiveve afatgjata materiale shqyrtohet dhe rregullohet nëse është e përshtatshme në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar. Vlera kontabel e një aktiviteti shpenzohet menjëherë deri në shumën e rikuperueshme. nëse vlera kontabel e aktivitetit është më e madhe se shumta e vlerësuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohet duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabel. Këto janë të përfshira në fitimin ose humbjen e periudhës financiare.

3. Politika kontabel te rëndësishme (vazhdim)**3.6 Aktivet afatgjata jo-materiale**

Aktivete afatgjata jo-materiale të blera nga shoqëria paraqiten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë (nëse ka), bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar pas datës së cilës ato janë të gatshme për përdorim. Jetëgjatësia dhe metoda e amortizimit të aktiveve afatgjata jo-materiale shqyrtohet, në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe efektet e ndryshimit merren parasysh në periudhat e ardhshme.

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Programe kompjuterike	Mbi vlerën kontabel neto	25%
Licenca	Metoda lineare	15%

Vlera kontabel e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, shqyrtohen në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë vlera e rikuperueshme e aktivitetit rivlerësohet. Kur vlera kontabel e tejkalon vlerën e rikuperueshme, njihet një humbje nga zhvlerësimi. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

3.7 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabel e një aktivi ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e vogël se vlera e tij e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet apo grupet e tjera të aktiveve. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, fluksat monetare të ardhshme skontojnë për të sjellë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të pasqyrës dhe rrezikun specifik të aktivitetit.

Në lidhje me aktivet e tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret në qoftë se ka ndonjë tregues që ky zhvlerësim nuk ekziston më dhe ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerat e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret deri në masën që vlera kontabel e aktivitetit nuk e kalon vlerën kontabel që do të ishte përcaktuar neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi, në qoftë se asnjë humbje nga zhvlerësimi nuk është njohur.

3.8 Zhvlerësimi i emrit të mire

Përcaktimi nëse emri i mire është zhvlerësuar kërkon një vlerësim të vlerës në përdorim të njësive gjeneruese të pasqyrës në të cilat emri i mire është shpërndarë. Llogaritja e vlerës në përdorim kërkon që drejtimi i Grupit të vlerësojë fluksat e ardhshme të pasqyrës që pritet të gjenerohen nga njësia gjeneruese të pasqyrës dhe një normë uljeje të pershtatshme në mënyrë që të llogaritet vlera aktuale e tyre. Kur fluksat e ardhshme të pasqyrës rezultojnë me pak se vlera e mbartur e emrit të mire, atëherë njihet një humbje nga zhvlerësimi i emrit të mire.

3.9 Inventarët

Inventarët maten me vlerën më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e çmuara të përfundimit dhe kostot e çmuara që duhen për realizimin e shitjes.

Kostot e inventarit përcaktohen duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar, e cila përfshin të gjitha kostot e blerjes, transportit, tarifave doganore dhe sigurimit gjatë transportit, kostot e konvertimit dhe çdo kosto tjetër që lidhet me inventarin për të sjellë atë në vendin dhe kushtet e punës.

3. Politika kontabel te rëndësishme (vazhdim)

3.10 Instrumentet financiare

Shoqëria zotëron vetëm instrumente jo derivativë financiare të përbëra nga klientë dhe llogari të tjera të arkëtueshme. mjete monetare dhe ekuivalente me to. hua, furnitorë dhe të tjera llogari të pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivativë njihen fillimisht me vlerë të drejtë. Për instrumentet e njohur jo me vlerë të drejtë kostot direkt atribueshme shkojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç siç është përkrahur si më poshtë. Pas njohjes fillestare njohja e instrumenteve financiarë jo-derivativë matet si më poshtë.

Një instrument financiar njihet në qoftë se shoqëria bëhet pjesë e një provigjonimi kontraktual mbi instrumentin. Instrumentet financiare pushojnë së njohuri në qoftë se të drejtat kontraktuale të shoqërisë për flukse monetare përfundojnë ose shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë tjetër pa zotëruar më kontroll mbi të ose në mënyrë domethënëse mbi rreziqet dhe përfitimet e aktivit.

Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit të tyre. që do të thotë në datën kur shoqëria angazhohet për të blerë apo shitur aktivin. Detyrimet financiare pushojnë së njohuri në qoftë se detyrimet kontraktuale të shoqërisë përfundojnë apo anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat rrjedhëse në banka apo investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet 3 ose më pak muaj, për të cilat rreziku i një ndryshimi në vlerën e drejtë është i pakonsiderueshëm. investime të cilat shoqëria i përdor për menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e tyre të amortizuar.

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë dhe vlerësuar më pas me kosto të amortizuar pakësuar me humbjet nga zhvlerësimi.

Një provizion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme njihet kur ka një evidence objektive që shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledh të gjitha shumat në përputhje me termat e llogarive të arkëtueshme.

Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia e falimentimit, riorganizimi financiar si dhe pagesat me vonesë janë tregues për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Shuma e provizionit është diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivitet me maturitet të shkurtër nuk skontohej. Vlera kontabël e aktivitetit zvogëlohet duke përdorur një llogari zhvlerësimi dhe vlera e humbjes njihet në fitim ose humbje. Kur një llogari e arkëtueshme është e pambledhshme, ajo mbyllet duke përdorur llogarinë e zhvlerësimit. Vlerat që mund të rikuperohen në të ardhmen për shumat e njohura si borxh i keq njihen në fitim ose humbje.

DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017
(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

3. Politika kontabel te rëndësishme (vazhdim)

Huatë

Pas njohjes fillestare huatë interes mbartëse janë paraqitur me kosto të amortizuar dhe çdo diferencë ndërmjet koston dhe vlerës së huasë është njohur në pasqyrën e të ardhurave përgjatë periudhës me bazë interesi efektiv.

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme

Llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve të tjerë janë paraqitur me vlerë të drejtë, rjedhimisht me koston e tyre të amortizuar.

Njohja e zhvlerësimit për aktivet financiare

Një aktiv financiar merret në konsideratë për efekt zhvlerësimi në qoftë se ekzistojnë tregues objektive që një ose më tepër ngjarje mund të kenë ndikim negativ në flukset e pritshme të ardhshme që do të gjenerojë ky aktiv.

Një humbje nga zhvlerësimi në raport me një aktiv financiar të matur dhe të amortizuar me kosto llogaritet si diferencë midis vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhme të skontuara me normën e interesit efektiv.

Aktivete financiare me vlerë të konsiderueshme testohen për zhvlerësim individual. Pjesa tjetër e aktiveve financiare grupohen në grupe me karakteristika rreziku të njëjta. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në fitim ose humbje. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret në qoftë se rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi fillestar. Rimarrja bëhet në fitim ose humbje.

3.10 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar konsiston në mjetet monetare të kontribuara nga themeluesit e shoqërisë. Kapitali aksionar paraqitet me vlerën në Lek të konvertuar me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksionar i shoqërisë njihet me vlerë nominale.

3.11 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitja e mallrave dhe kryerja e shërbimeve. Të ardhurat nga produktet dhe shërbimet kryesore paraqiten në shënimin 14.

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të parave të marra ose të arkëtueshmeve nga shoqëria për mallrat e dhëna ose shërbimet e kryera, duke përfshirë taksat e shitjes, rabatet, dhe uljet tregtare.

Shoqëria aplikon kriteret e njohjes së të ardhurave të përcaktuara si më poshtë tek çdo komponent i veçantë i transaksionit të shitjes në mënyrë që të reflektoje thelbin e transaksionit. Të ardhurat e marra nga këto transaksione janë alokuar tek komponentët e veçantë të identifikuar duke patur parasysh vlerën relative të drejtë të çdo komponenti. Të ardhurat njihen kur vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri, mbledhja është e mundshme, kostoja e ndodhur ose që do të ndodhë mund të matet me besueshmëri, dhe kur kriteret për çdo aktivitet të ndryshëm të shoqërisë janë plotësuar.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.11 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

Këto kritere njohje specifike për çdo aktivitet janë bazuar në mallra dhe zgjidhje të dhëna klientit dhe në kushtet e kontratës për çdo rast dhe përshkruhen më poshtë:

Shitja e mallrave – me pakicë

Shitja e mallrave njihet kur produktet i shiten konsumatorit. Shitjet me pakicë bëhen zakonisht me para ose me kartë krediti. Të ardhurat e njohura janë vlerat e shitjes bruto, duke përfshirë tarifat e kartës së kreditit të pagueshme për transaksionin.

Ofrimi i shërbimeve

Të ardhurat nga shitja e shërbimeve do të njihen në periudhën në të cilën shërbimet ofrohen, duke iu referuar fazës së realizimit të tyre në qoftë se një gjë e tillë mund të matet në mënyrë me besueshmëri.

Të ardhurat nga interesat

Të ardhurat nga interesat përlogariten në mënyrë të vazhdueshme mbi baza kohore, bazuar në principalin e mbetur dhe normës së interesit efektiv të aplikueshme cila është norma që skanton dhe barazon saktësisht të flukset monetare të ardhshme përgjatë jetës së pritshme të aktivitetit financiar me vlerën kontabël neto të aktivitetit.

3.12 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurime shoqërore

Gjatë ushtrimit të aktivitetit operativ, shoqëria kryen pagesa periodike për llogari të punonjësve për pjesën që ligjërisht i takon të paguajë shoqërisë dhe punonjësve për të kontribuar për fondet e detyrueshme të pensioneve sipas rregulimeve të legjislacionit vendas. Kostot e shoqërisë janë përfshirë në llogaritjen e rezultatit të periudhës.

3.13 Tatim fitimi i vitit dhe tatim fitimi i shtyre

Shpenzimet për tatim fitimin përfshijnë tatim fitimin aktual dhe tatim fitimin e shtyre. Shpenzimet për tatim fitimin njihen në fitim ose humbje deri përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera përmbledhëse.

Tatimi mbi fitimin aktual është tatimi i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme duke përdorur normat e taksimit në datën e raportimit dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm të lidhur me vitin e kaluar. Tatimi mbi fitimin i aplikueshëm është 15% e fitimit të tatueshëm.

Tatim fitimi i shtyre njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyre matet me normat tatimore që pritet të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato ndryshojnë, duke u bazuar në ligjet që kanë qenë ose janë në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyre njihet në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion për të mbuluar diferencat e përkohshme. Aktivitet tatimor të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në qoftë se përfitimet tatimore nuk do të jenë më të mundshme për tu realizuar.

3.14 Provigjonet

Provigjonet njihen kur shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhje e burimeve që përfshijnë përfitimet ekonomike do të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin dhe kur një vlerësim i besueshëm i vlerës së detyrimit mund të bëhet. Nëse efekti është material, provigjonet llogariten duke zbritur vlerën e pritshme të mjeteve monetare të

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.14 Provigjonet (vazhdim)

ardhshme para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë. dhe kur është e nevojshme rrezikun specifik të detyrimit.

Provigjonet rishikohen ne çdo datë raportimi dhe nëse nuk është më e mundshme që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. provigjoni anulohet. Provigjonet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provigjonet nuk njihen për humbje të ardhme operative. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në kontabilitet.

3.15 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet shpjeguese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme. Shuma e një humbje të kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provigjionin. një detyrim njihet ne datën e Pasqyrës e pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet ne mënyrë të besueshme.

3.16 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë. së bashku me entitete që ata kontrollojnë. të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme . vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

3.17 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e Pasqyrës se pozicionit financiar (veprimet rregulluese). janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

4 Menaxhimi i rrezikut financiar

4.1 Faktorët e rrezikut financiar

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare. që përfshijnë rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të shoqërisë.

Menaxhimi i rrezikut kryhet nga drejtimi bazuar në politika të aprovuara dhe procedura që mbulojnë gjithë menaxhimin e rrezikut. si dhe çështje specifike. si rreziku i kursit të këmbimit. rreziku i normës se interesit. rreziku i kreditit. përdorimi i letrave me vlerë të përshtatshme dhe investimi i likuiditetit të tepërt.

4.2 Rreziku i tregut

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen si rezultat i ekspozimit në monedha të ndryshme kryesisht në lidhje me Euro-n. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për tu mbrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur pozicione neto të përshtatshme në çdo monedhë dhe në total dhe të monitorojë operacionet e përditshme.

Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqërisë të shprehura në monedhë të huaj në 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017
(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.2 Rreziku i tregut (vazhdim)

	31 Dhjetor 2017			Total
	EUR	USD	LEK	
Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme	39.842.715	-	28.659.330	68.502.045
Te arketueshme nga palet e lidhura	10.418.166	-	-	10.418.166
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	3.940.494	-	6.310.381	10.250.875
	54.201.375	-	34.969.711	89.171.086
Detyrime ndaj institucioneve financiare	8.270.581	-	-	8.270.581
Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme	-	-	85.990.044	85.990.044
Detyrime ndaj paleve te lidhura	12.694.884	-	-	12.694.884
	20.734.661	-	85.990.044	106.955.509
Risku i monedhes ne 31 Dhjetor 2017	33.235.910	-	(51.020.333)	(17.784.423)

	31 Dhjetor 2016			Total
	EUR	USD	LEK	
Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme	27.443.033	-	124.045.101	151.488.134
Te arketueshme nga palet e lidhura	8.871.423	-	-	8.871.423
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	1.461.210	114	4.631.098	6.092.422
	37.775.666	114	128.676.199	166.451.979
Detyrime ndaj institucioneve financiare	7.757.942	-	185.861	7.943.803
Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme	-	-	147.752.007	147.752.007
Detyrime ndaj paleve te lidhura	13.988.900	-	1.209.638	15.198.538
	21.746.842	-	149.147.506	172.922.801
	16.028.824	114	(20.471.307)	(4.442.369)
Risku i monedhes ne 31 Dhjetor 2016	27.443.033	-	124.045.101	151.488.134

	Kapitalet e veta	Fitime ose (humbje)
2017		
EUR	3.323.591	(3.323.591)
2016		
EUR	1.602.882	(1.602.882)

Analiza e ndjeshmerise se monedhes se huaj

Analiza e ndjeshmerise perفشin vetem zerat monetare te shprehura ne monedhe te huaj ne fund te vitit. dhe nje korrigjim i vlerave te tyre i bere per nje 10% ndryshim ne kurset e kembimit. Vlera pozitive/negative tregojne rritje/ulje ne fitim ose ne kapital qe ndodh kur leku dobsohet/forcohet ne vleren e tij kundrejt monedhave te huaja me +/- 10%.

DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017
(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.3 Rreziku i kreditit

Shoqëria krijon një fond provigjoni për zhvlerësim i cili përfaqëson vlerësimet e shoqërisë për humbjet e ndodhura në lidhje me llogaritë e arketueshme bazuar tërësisht në humbjet specifike të lidhura me ekspozime individualisht të rëndësishme. Në 31 Dhjetor 2016 fondi i provigjoni për zhvlerësim vendosur në masën e mbulimit të tejkalimit të humbjeve.

Ekspozimi maksimal i shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit është përfaqësuar nga vlerat kontabël të çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar të përmbledhura si më poshtë:

	2017	2016
Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme (shenimi 15)	68.502.045	151.488.134
Te arketueshme nga palet e lidhura (shenimi 16)	10.418.166	8.871.423
Mjete monetare dhe ekuivalente me to (shenimi 18)	10.250.875	6.092.422
	89.171.086	166.451.979

Rreziku i kreditit për mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre konsiderohet i papërfillshëm sepse palët e lidhura janë banka me reputacion dhe me vlerësime të cilësisë së lartë.

Zhvlerësimet

Vjetërsia e llogarive te arketueshme ne datën e raportimit eshte si me poshtë:

	31 Dhjetor	
	2017	2016
Te pavonuara	11.360.589	53.316.813
Me shume se 30 dhe me pak se 60 dite	8.105.067	39.528.198
Me shume se 60 dhe me pak se 90 dite	137.157,10	6.137.273
Me shume se 90 dhe me pak se 120 dite	321.724,70	110.999
Me shume se 120 dhe me pak se 360 dite	42.180.286	6.279.345
Me shume se 360 dite	7.257.645	42.345.452
	68.903.587	147.718.080
Balanca ne fund	68.903.587	147.718.080

DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017
(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

4.3 Rreziku i likuiditetit

Shoqëria menaxhon nevojat e saj për likuiditet duke monitoruar me kujdes pagesat e skeduluara të borxhit që rezultojnë nga detyrimet financiare si dhe parashikon hyrjet dhe daljet monetare në biznesin e përditshëm. Nevojat për likuiditet monitorohen në kohë të ndryshme. Kërkesat neto për para krahasohen me huamarrjet e disponueshme në mënyrë që të përcaktohet çdo mungesë. Kjo analizë tregon nëse huamarrjet e disponueshme priten të jenë të mjaftueshme gjatë periudhës së vëzhguar. Shoqëria mban para për të përballuar kërkesat për likuiditet për një periudhë minimalisht prej 30 ditësh. Gjithashtu, financimi për nevojat afatgjata për likuiditet sigurohet përmes huamarrjes. Shoqëria ka mbështetje të vazhdueshme nga shoqëria mëmë përmes huave që sigurojnë menaxhimin e likuiditetit si dhe financim të jashtëm nga bankat.

Me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016, detyrimet e shoqërisë kanë maturitete kontraktuale (përfshirë pagesat e interesit kur aplikohen) si më poshtë:

31 Dhjetor 2017					
	Deri ne 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme	68.502.045	-	-	-	68.502.045
Te arketueshme nga palet e lidhura	10.418.166	-	-	-	10.418.166
Aktive te tjera	70.775	-	-	-	70.775
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	10.250.875	-	-	-	10.250.875
	89.241.861	-	-	-	89.241.861
Detyrime ndaj institucioneve financiare	8.270.581	-	-	-	8.270.581
Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme	85.990.044	-	-	-	85.990.044
Detyrime ndaj paleve te lidhura	12.694.884	-	-	-	12.694.884
	107.216.919	-	-	-	107.216.919
Risku i likuiditetit	(17.975.058)	-	-	-	(17.975.058)

31 Dhjetor 2016					
	Deri ne 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme	151.488.134	-	-	-	151.488.134
Te arketueshme nga palet e lidhura	8.871.423	-	-	-	8.871.423
Aktive te tjera	4.582.291	-	-	-	4.582.291
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	6.092.422	-	-	-	6.092.422
	171.034.270	-	-	-	171.034.270
Detyrime ndaj institucioneve financiare	7.241.046	600.397	102.360	-	7.943.803
Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme	147.752.010	-	-	-	147.752.010
Detyrime ndaj paleve te lidhura	15.198.538	-	-	-	15.198.538
	170.191.594	600.397	102.360	-	170.894.351
Risku i likuiditetit	842.676	(600.397)	(102.360)	-	139.919

DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017
(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

4.5 Menaxhimi i riskut të kapitalit

Objektivat e shoqërisë në menaxhimin e kapitalit janë të ruajë aftësinë e shoqërisë për të vazhduar biznesin në vijimësi në mënyrë që të sigurojë përfitime për aksionaret dhe përfitime për palët e tjera të interesuara dhe të mbajë një strukturë optimale kapitali për të reduktuar koston e kapitalit.

Raporti borxh/ kapital

Struktura e kapitalit të shoqërisë përbëhet nga detyrime dhe kapital. që përbëhet nga kapitali i pronareve dhe humbjet e akumuluar. Drejtimi rishikon strukturën e kapitalit në terma vjetore si një lidhje ndërmjet detyrimeve për huatë dhe totalit të kapitalit.

Treguesit e borxhit në fund te vitit janë si më poshtë:

	2017	2016
Huatë	8.270.581	7.943.803
Kapitali aksionar	3.500.000	3.500.000
	2,36	2,27

5 Gjykime dhe vlerësime të rëndësishme kontabël

Në aplikimin e politikave kontabël të shoqërisë, që përkrahur në Shënimin Nr. 3 të këtyre pasqyrave financiare, drejtimit i kërkohet që të bëjë gjykime, çmuarje, dhe supozime për vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë qartësisht të dukshme nga burime e tyre. Çmuarjet dhe supozimet e lidhura me to janë të bazuara në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto çmuarje.

Çmuarjet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimet në çmuarjet kontabël do të njihen në periudhën në të cilën çmuarja është rishikuar në qoftë se rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe në periudhat e ardhshme në qoftë se rishikimi ndikon periudhën aktuale dhe ato të ardhme.

Pasiguria ne gjykime

Zhvlërësimi i aktiveve jo-financiare

Humbjet nga zhvlërësimi do të njihen me shumën me të cilën vlera kontabël e aktiveve ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlerëson çmimet e pritshme dhe flukset e parasë nga çdonjësi gjeneruese të mjeteve monetare dhe përcakton një normë interesi të përshtatshme kur llogaritet vlera aktuale e këtyre flukseve të parasë.

Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi rishikon në mënyrë të vazhdueshme jetën e dobishme të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Drejtimi vlerëson se jeta e dobishme e aktiveve reflekton dobishmërinë e pritur të këtyre aktiveve. Vlera e mbetur e këtyre aktiveve është analizuar në Shënimin Nr. 6. Megjithatë, rezultatet reale mund të ndryshojnë për shkak të konsumimit teknologjik.

Zhvlërësimi i aktiveve financiare

Zhvlërësimi i llogarive të arkëtueshme

Shoqëria llogarit zhvlërësimin për llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera bazuar në humbjet e vlerësuar që rezultojnë nga paafërsia e klientëve për të bërë pagesat e detyrimeve të tyre. Vlerësimi është bazuar në analizën e vjetërsisë të llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën historike të nxjerrjes jashtë librave kontabël. Cilësinë e klientit dhe ndryshimet në termat e pagesës së klientit kur vlerësohet saktësia e humbjes nga zhvlërësimi për llogaritë e dyshimta.

DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017
(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

5 Gjykime dhe vlerësime të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Kjo përfshin supozime për sjelljen e ardhshme të klientit dhe mbledhjet e ardhshme të parave. Në qoftë se kushtet financiare të klientit përkeqësohen, çregjistrimet aktuale të llogarive të arkëtueshme ekzistuese mund të jenë më të larta se sa priten dhe mund të kalojnë nivelin e humbjeve nga zhvlerësimi të njohura deri tani.

Inventarë

Inventari është paraqitur me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Gjatë përcaktimit të vlerës neto të realizueshme, drejtimi merr parasysh evidencat me objektive/ të dhënat e disponueshme për kryerjen e vlerësimeve.

6. Te ardhurat

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016
Te ardhurat nga media	44.579.166	118.700.824
Te ardhurat nga produksione	82.865.766	140.367.165
Te ardhurat nga dizajni	2.880.681	1.584.395
Te ardhura nga spote publicitare	-	1.091.891
Te ardhura nga tarifa fikse	14.502.646	11.982.594
Te ardhura te tjera	-	559.066
Totali	144.828.259	274.285.935

7. Kosto te sherbimeve te siguruara

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016
Kosto mediatike	93.022.561	168.028.572
Kosto produksioni	9.423.500	37.302.006
Totali	102.446.062	205.330.578

8. Shpenzime personeli

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016
Paga dhe shperblime	32.157.221	36.354.811
Kontribute shoqerore dhe shendetesore	3.293.843	3.030.504
Totali	35.451.064	39.385.315

DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017
(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

9. Shpenzime administrative

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2017	Year ended 31 Dhjetor 2016
Qira	3.027.122	3.761.810
Posta dhe komunikimi	1.577.921	1.788.595
Udheime dhe dieta	1.529.366	550.757
Detyrime dhe taksa te tjera	1.631.866	626.994
Auditime dhe Konsulenca	6.751.628	7.068.362
Sigurime	130.877	150.138
Shpenzime Zyre	4.654.570	3.864.887
Te tjera shpenzime operative	1.078.671	6.624.503
Komisione bankare	530.345	680.935
Totali	20.912.366	25.116.981

10. Te ardhura financiare

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2017	Year ended 31 Dhjetor 2016
Fitime nga kembimet valutore	383.672	191.530
Te ardhura nga interesat	4.986	-
Totali	388.658	191.530

11. Shpenzime financiare

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016
Shpenzime per interesa	656.511	290.317
Humbje nga kembimet valutore	466.575	549.615
Totali	1.123.086	839.932

12. Shpenzime te tatimit mbi fitimin

	Norma efektive tatimore	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2017	Norma efektive tatimore	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016
Fitimi/(humbja) para tatimit		(21.176.880)		(112.996)
Taksa Prima facie	15,00%	(3.176.532)	15,00%	(16.949)
Shpenzime te pazbritshme	-1,91%	405.262	-193,42%	218.557
Te ardhura te patatueshme	-	-	-28,93%	32.690
Efektet e humbjeve tatimore per t'u mbartur ne periudhat e ardhshme	-13,09%	2.771.270	64,88%	(73.312)
Shpenzime te tatimit mbi fitimin	-	-	-142,47%	160.986

Me 31 dhjetor 2017 humbja tatimore per t'u mbartur ne vitet e ardhshme rezultonte ne shumen 2.771.270 Lek, per te cilen nuk eshte njohur nje aktiv tatimor i shtyre nga Shoqeria.

DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017
(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

13. Aktive jo-materiale

	Software
Kosto	
Gjendja me 1 janar 2016	1.980.559
Pakesime	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2016	1.980.559
Shtesa	72.450
Pakesime	(667.382)
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	1.385.627
Amortizimi i akumuluar	
Gjendja me 1 janar 2016	(718.670)
Shtesa	(176.628)
Rimarrje amortizimi	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2016	(895.298)
Shtesa	(150.527)
Rimarrje amortizimi	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	(1.045.825)
Vlera neto e aktiveve	
Gjendja me 1 janar 2016	1.261.889
Gjendja me 31 Dhjetor 2016	1.085.261
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	339.802

DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017
(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

14. Aktive materiale

	Pajisje kompjuterike	Pajisje Zyre	Te tjera	Automjete	Automjete me leasing	Total
Kosto						
Gjendja me 1 janar 2016	6.808.207	3.775.365	4.347.383	11.115.714	6.547.570	32.594.239
Shtesa	607.848	1.877.163	-	233.480	-	2.718.491
Dalje	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2016	7.416.055	5.652.528	4.347.383	11.349.194	6.547.570	35.312.730
Shtesa	647.756	711.901	-	-	-	1.359.657
Dalje	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	8.063.811	6.364.430	4.347.383	11.349.194	6.547.570	36.672.388
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja me 1 janar 2016	(5.385.443)	(1.710.911)	(1.141.698)	(6.496.703)	-	(14.734.755)
Amortizimi vjetor	(795.619)	(400.953)	(276.124)	(1.220.727)	(1.047.611)	(3.741.034)
Rimarrje amortizimi	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2016	(6.181.062)	(2.111.864)	(1.417.822)	(7.717.430)	(1.047.611)	(18.475.789)
Shtesa	(769.193)	(689.985)	(150.355)	(1.047.641)	(1.047.611)	(3.704.786)
Dalje	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	(6.950.255)	(2.801.850)	(1.568.177)	(8.765.071)	(2.095.222)	(22.180.575)
Vlera neto e aktiveve						
Gjendja me 1 janar 2016	1.422.764	2.064.454	3.205.685	4.619.011	6.547.570	17.859.484
Gjendja me 31 Dhjetor 2016	1.234.993	3.540.664	2.929.561	3.631.764	5.499.959	16.836.941
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	1.113.555	3.562.580	2.779.207	2.584.123	4.452.348	14.491.813

DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017

(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

15. Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Llogari te arketueshme tregtare	67.757.471	147.718.080
Te ardhura te llogaritura	-	2.863.240
Te tjera te arketueshme	744.575	906.814
Totali	68.502.045	151.488.134

16. Te arketueshme nga palet e lidhura

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Te arketueshme nga administratori	-	-
Detyrime nga palet e lidhura	10.418.166	8.871.423
Totali	10.418.166	8.871.423

17. Tatim fitimi i parapaguar

	31 December 2017	31 December 2016
Balanca e hapjes	413.691	1.597.208
Pagesa te detyrimit te tatim-fitimit nga viti i kaluar		
Parapagime te tatim-fitimit gjate vitit	(264.481)	(1.022.531)
Shpenzimi i tatim-fitimit te vitit	-	(160.986)
Balanca e mbylljes	149.210	413.691

18. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Arka	507.799	654.647
Banka	9.743.076	5.437.775
Ne Lek	5.802.581	4.603.424
Ne Eur	3.940.494	834.351
Totali	10.250.875	6.092.422

19. Aktive te tjera

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shpenzime te shtyra	54.356	4.582.291
Totali	54.356	4.582.291

DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017
(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

20. Detyrime ndaj institucioneve financiare

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Overdraft - referohuni tek (a) me poshte	8.270.581	6.664.114
Qira - referohuni tek (b) me poshte	-	1.279.689
Totali	8.270.581	7.943.803

a) Overdraft

Ne vitin 2011 DDB Albania nenshkroi nje marreveshje overdrafti me Raiffeisen Bank per shumen limit prej 50,000 Euro me fillimisht me afat 1 vjecar me mundesi rinovimi prej 5 vjetesh. Norma e interesit eshte e ndryshueshme Euribor 12M plus 6.5% por jo me pak se 8%. Gjendja e overdraftit me 31 Dhjetor 2017 ishte 8.270.581 Leke (31 Dhjetor 2016: 6.664.114 Leke)

b) Qira

Ne 11 Shkurt 2013, DDB Albania nenshkroi nje marreveshje qiraje financiare me Tirana Leasing per nje vlere 37.600 Euro me maturim ne 11 Shkurt 2018. Norma e interesit eshte e ndryshueshme Euribor 12 muaj + 5%. Me 31 dhjetor 2017 pjesa afatshkurter e qirase financiare ishte 0 Leke (31 Dhjetor 2016: 1.177.329 Leke) dhe pjesa afatgjate ishte Leke (31 Dhjetor 2016: 102.360 Leke).

21. Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Llogari te pagueshme tregtare	81.554.718	132.429.395
TVSH e pagueshme, neto	1.761.304	2.829.286
Te pagueshme ndaj personelit	110.582	258.667
Taksa dhe detyrime te tjera	735.565	1.813.227
Shpenzime te llogaritura dhe detyrime	1.827.875	10.421.435
Totali	85.990.044	147.752.010

22. Detyrime ndaj paleve te lidhura

	31 Dhejtor 2017	31 Dhjetor 2016
Dividente te pagueshem ndaj aksionereve te pakices	1.287.913	1.178.470
Te pagueshme ndaj paleve te lidhura	11.406.971	14.020.068
Totali	12.694.884	15.198.538

DDB Albania Sh.a.

Pasqyrat financiare te konsoliduara per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017

(Shumat ne Leke, nese nuk specifikohet ndryshe)

23. Palet e lidhura

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Te tjera te arketueshme nga DBB Tribal	40.123	40.123
Te tjera te arketueshme nga DBB Montenegro	10.378.044	8.831.300
Te arketueshme nga SPOT COMMUNICATIONS SHPK	500.000	500.000
Totali detyrimeve nga palet e lidhura	10.918.166	9.371.423
Te pagueshme ndaj Olympic DDB Holding	11.786.947	13.645.263
Totali i detyrimeve ndaj paleve te lidhura	11.786.947	13.645.263
Totali i shpenzimeve te pergjithshme e faturuar nga Olympic DDB S.A.	-	5.866.058
Totali i shpenzimeve te pergjithshme e faturuar nga palet e lidhura	-	5.866.058
Kompesimi i menaxhimit	7.800.000	7.800.000

24. Ngjarjet pas datës se raportimit

Nuk ka ngjarje te rendesishme pas dates se raportimit qe do te ishte e nevojshme te te paraqiteshin si rregullime ose informacione shtese ne keto pasqyra financiare.